



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2024:073695  
Datë: 10.01.2025  
Numri i dokumentit: 06763824

**P.nr.617/24**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtarja e vetme gjykuese Edita Çanta, me Bashkëpunëtorin Profesional Lavdim Mehmeti, në çështjen penale ndaj të pandehurit D. D., për shkak të veprave penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së dhe Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, me shenjën PP.II.nr.959/24, të datës 18.03.2024, pas mbajtjes së seancës dëgjimore të datës 20.12.2024 për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, e hapur për publikun, në të cilin seancë ishin të pranishëm Prokurori i shtetit Nazmi Krasniqi, i pandehuri D. D. me mbrojtësin e tij sipas autorizimit, av.Asdren Hoxha, e në bazë të nenit 365 të KPPK-së, me dt.20.12.2024, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 10.01.2025, e përpiloi me shkrim këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri D. D.**, nga i ati Xh., dhe e ema N., e gjinisë B., i lindur me ///, në B., me vendbanim në rrugën “H. A.” nr.. P., me nr.pers.1///4, i pa punë, ka të kryer shkollën fillore, me profesion elektrikist, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse:

I. Me pare e deri më datën 12.01.2024 rreth ores 08:00, në Rr.“Mihail Grameno”, në Prishtine, i pandehuri, me dashje dhe vetëdije e në kundërshtim me nenin 3 pika 1.1 lidhur me nenin 4 të Ligjit 2 , pa autorizim, ka mbajtur në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar armë dhe municion dhe atë një (1) pushke automatike AK-47, me nr.serik 14188814 dhe 2 karikator, në atë mënyre që ditën kritike gjate zbatimit te urdher kontrollit në shtëpinë e të pandehurit nga ana e policisë saktësisht nen shtrat në dhomën e gjumit është gjetur arma e lartëcekur dhe 2 karikator te zbrazur, të cilat janë sekuestruar nga ana e policise.

- me këtë i pandehuri ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së dhe

II.Me datë 01.01.2024 rreth ores 00:05min, në Rr.“Mihail Grameno”, në Prishtine, saktësisht në shtëpinë e tij, i pandehuri, ka përdorur armë zjarri në kundërshtim me Ligjin 3 , dhe atë pushke

automatike AK-47, me nr.serik 14188814, të cilen e posedonte pa leje, në atë mënyrë që natën kritike i pandehuri gjatë ndërrimit të mote moteve në shenjë gëzimi, merr armen e larcekur dhe shtën 20 here në ajër, me ç`rast arma e lartcekur së bashku me 2 karikator të zbrazur, është sekuestruar nga ana e zyrtarëve policor, tek i pandehuri me datën 12.01.2024.

- Me këtë i pandehuri ka kryer veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjyqtarja e vetme, në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 17, 38, 43, 44, 73, 74 të KPRK-së, si dhe nenit 230 dhe 365 të KPPK-së, të njëjtin:

## E GJYKON

I.Për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, **dënim me gjobë në shumë prej 1300 € (njëmijë e treqind euro).**

II.Për veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, **dënim me burg me kusht në kohëzgjatje prej 1 viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 viti**, nëse i pandehuri brenda periudhës verifikuese nuk kryen vepër tjetër penale.

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin e shqiptuar, gjykata konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgim duke llogaritur çdo 20 (njëzet) Euro me një ditë burgim.

III.Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajnë shumën aq sa do të bëhet sipas llogaritjes përfundimtare nga arka e gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej tridhjetë (30) euro, në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej njëzet (20) euro të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbartimit me dhunë

**IV.Konfiskohet:** arma e tipit ‘AK 47’, me numër serik 14188814, me dy karikator, dhe urdhërohet shkatërrimi pasi aktgjykimi të merr formën e prerë, nga Policia e Kosovës në bashkëpunim me Prokurorin Themelore në Prishtinë, pasi të vërtetohet se kjo armë nuk është përdorur në ndonjë rast tjetër penal.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë–Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën nën shenjen PP/II.nr 959/24, të datës 18.03.2024, me të cilën ka akuzuar të akuzuarin D. D. për shkak të veprave penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së dhe “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” nga neni 367 par.1 të KPRK-së. Së bashku me aktakuzën e lartëcekur, Prokuroria e shtetit ka dorëzuar edhe marrëveshjen për pranimin e fajësisë të lidhur mes të akuzuarit me mbrojtësin e tij dhe prokurorin e shtetit, e cila marrëveshje mban shenjen PP.I.nr.959/24 të datës 12.03.2024.

Gjykata, në përputhje me autorizimet ligjore me datën 20.12.2024 ka mbajtur seancë dëgjimore për vlerësimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë të lidhur mes të akuzuarit me mbrojtësin e tij dhe prokurorin e shtetit. Në këtë seancë kanë prezantuar prokurori i shteti, Nazmi Krasniqi, i akuzuari D. D. dhe mbrojtësi i tij av. Asdren Hoxha sipas autorizimit. Gjykata me kujdes të shtuar ka trajtuar dhe analizuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, ka analizuar te gjithë bazën ligjore dhe procedurale qe duhet ndjekur ne rastin konkret.

Gjykata edhe njëherë në seance, ne prani te mbrojtësit të të akuzuarit, e ka njoftuar te akuzuarin lidhur me marrëveshjen, e po ashtu i janë parashtruar pyetjet e nevojshme për të sqaruar faktin se i akuzuari a e ka kuptuar në tërësi marrëveshjen, e po ashtu edhe benefitet edhe pasojat që përmban kjo marrëveshje. *I akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar marrëveshjen, pasojat dhe benefitet që qëndrojnë pas kesaj marrëveshjeje, dhe se qëndron pas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë.*

Gjykata gjatë seancës dëgjimore ka vazhduar me marrjen e mendimit të palëve tjera në procedurë penale, me c’rast:

Prokurori i shtetit lidhur me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë në seancën dëgjimore ka deklaruar: *“Marrëveshja është në përputhje me nenin 230 të KPPK, dhe si të tillë i propozojmë gjykatës që ta miratoj këtë pranim të fajësisë”*.

Mbrojtësi i të akuzuarit D. D., av.Asdren Hoxha, lidhur me marrëveshje për pranimin e fajësisë ka deklaruar se: *”E mbështes marrëveshjen e nënshkruar për pranimin e fajësisë dhe kërkoj që të pandehurit dënimi të paguhet në dy ose tri këste për shkak të gjendjes ekonomike”*.

I akuzuari D. D. ka deklaruar se e pranon fajësinë dhe qëndron pranë marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë.

Gjykata, duke u mbështetur në nenin 230, par.17, 18 dhe 20 të KPPRK-së, nga të cilat dispozita rrjedh detyrimi ligjor i gjykatës që të sigurohet se i pandehuri D. D. ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, nëse ka mbrojtës, dhe se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtremëguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë; se pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret, të cilat paraqiten në aktakuzë, apo me provat materiale të paraqitura nga prokurori për plotësimin e aktakuzës dhe të pranuar nga i pandehuri, si dhe me dëshmi tjera, siç mund të jenë deklaratat e dëshmitarëve të paraqitura nga prokurori apo i pandehuri dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 248, paragrafi 1, të Kodit, pasi ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore, duke u bazuar edhe në nenin 233 par.18 të KPPRK-së, dhe në kuptim të nenit 230 par.20 të KPPRK-së të KPPRK-së, me aktvendim ka pranuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë të lidhur me prokurorit të shtetit, të akuzuarit me mbrojtësin e tij.

Pas kësaj gjykata ka ftuar palët që të deklarohen lidhur me lartësinë e dënimit, meqenëse dënimi ka qenë dënim i rekomanduar, me c'rast:

Prokurori i shtetit ka deklaruar: *“Duke pasur parasysh rrethanat dhe pendimit të kryerjes së veprës penale nga i pandehuri, në përputhje me dispozitat ligjore dhe ato të KPPRK, për propozimin e marrëveshje të pranimit të fajësisë, se i njëjti ka qenë i akuzuar edhe për veprën penale të armëmbajtjes pa leje, për të cilën veprë e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, dhe për këtë nuk jemi lëshuar në negocim”.*

Mbrojtësi i të akuzuarit Av.Asdren Hoxha ka deklaruar se: *“Qëndrojmë mbrapa marrëveshjes që kemi arritur me prokurorin e shtetit”.*

I akuzuari D. D. ka deklaruar se: *“Qëndroj prapa marrëveshjes për pranimit fajësie”.*

Andaj, duke u bazuar në të lartë cekurat, nisur nga rrethanat e vërtetuara në procedurë, nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, e po ashtu edhe nga vetë marrëveshja për pranimin e fajësisë, gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit formësohen të gjitha elementet qenësorë objektive dhe subjektive të veprave penale për të cilën është shpallur fajtor dhe është dënuar. Gjykata duke u bazuar në të cekurat më lartë të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin e rekomanduar në marrëveshjen për pranimin e fajësisë, pasi që gjeti se i njëjti është penalisht përgjegjës dhe se nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale.

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit, ka vlerësuar se duhet të aprovohet rekomandimi i paraqitur në marrëveshjen për pranimin e fajësisë që ndaj të akuzuarit ti shqiptohet dënim me gjobë dhe kusht, ashtu që gjykata në rastin konkret ka vlerësuar si dënim meritore dënimin e rekomanduar, ngase ka vlerësuar se ky dënim do të jetë i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale.

Duke u bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, gjykata i ka marrë për bazë disa rrethana që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Si rrethana lehtësuese për të pandehurin, gjykata e ka marrë bashkëpunimin të pandehurit me organet e drejtësisë që në fazat e hershme të procedurës penale dhe gatishmërinë e tij që të lidh marrëveshje mbi pranimit fajësie për të dy veprat penale, që shpërfaq një sens pendimi dhe është indikator për gjykatën se i njëjti është i vetëdijsëm për veprat penale, pasojat e tyre dhe nuk do t'i përsëris më as të njëjtat, e as të tjera. Ndërsa rrethanë rënduese gjykata ka gjetur.

Sipas bindjes së gjyqtarës, dënimi me gjobë dhe kusht ndaj të pandehurit për veprat penale të cilat i vihen në barrë, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjyqtarja e çështjes, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e

veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me kompensimin e viktimave të krimit u mor në bazë Ligjit nr.05/L-036.

Vendimi për konfiskimin e armës është marrë konform nenit 366 par.3 të KPRK-së.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**

**Departamenti i përgjithshëm-Penal**

**P.nr.617/24, të datës 10.01.2025**

**Bashkëpunëtori Profesional,**  
Lavdim Mehmeti

**Gjyqtarja,**  
Edita Çanta

### **UDHËZIMI JURIDIK:**

Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda tridhjetë (30) ditëve, nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.